

URDHËR
Nr. 284, datë 28.6.2013

**PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT PËR DEPOZITIMIN E TË DHËNAVE PËR AGJENCITË
NDËRMJETËSUESE TË HUAJA, TË LICENCUARA PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË
FUSHËN E BIRËSIMIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 399, datë 1.6.2011 “Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja”,

URDHËROJ:

1. Krijimin e regjistrit për depozitimin e të dhënave për agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të licencuara për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimit (më poshtë “Regjistri”).

2. Personi i autorizuar përgjegjës për administrimin e regjistrit, regjistron të dhënat për agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të licencuara, të paraqitura nga Komisioni për Miratimin të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, pas miratimit për dhënien e licencës.

3. Regjistri mbahet në formë elektronike (digjitale).

4. Faqet e regjistrit ndahen në 9 kolona, sipas modelit të paraqitur në shtojcën bashkëlidhur këtij urdhri. Kolonat kanë emërtimet e mëposhtme:

a) nr. (numri rendor i kërkesës që do të regjistrohet);
b) data e depozitimit të kërkesës;
c) identiteti i personit të autorizuar për të paraqitur kërkesën (emri, atësia, mbiemri, vendlindja dhe vendbanimi);

d) numri i licencës;

e) data e fillimit të veprimtarisë nga shteti përkatës për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimeve;

f) emri/emrat e drejtuesve të agjencisë ndërmjetësuese të huaj (emri, atësia, mbiemri, vendlindja dhe vendbanimi);

g) emërtimi dhe lloji i shoqërisë;

h) selia e shoqërisë;

i) shënime (pasqyrohen të dhënat që nuk përfshihen në rubrikat e tjera dhe që çmohen se janë të rëndësishme për t’u pasqyruar).

5. Të dhënat e pasqyruara në Regjister hartohen edhe në formatin shkresor, i cili, pasi nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit, vulozet dhe ruhet në sektorin e arkiv protokollit.

6. Personi i autorizuar përgjegjës, i caktuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, për administrimin e Regjistrit për depozitimin e të dhënave për agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të licencuara përditëson të paktën një herë në vit Regjistrin dhe siguron publikimin e tij në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

SHTOJCA 1
REGJISTRI I AGJENCIVE NDËRMJETËSE TË HUAJA, TË LICENCUARA

[illegible]